



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LIGJI Nr. 03/L-187

PËR MJEKËSINË LIGJORE

Kuvendi i Republikës së Kosovës;

Në mbështetje të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton

LIGJ PËR MJEKËSINË LIGJORE

KREU I
DISPOZITAT PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi i ligjit

1. Qëllimi i këtij ligji është rregullimi i procedurës për kryerjen e ekzaminimeve mjekoligjore nën autoritetin e Departamentit të Mjekësisë Ligjore.
2. Ekspertët mjekoligjor kryejnë detyrat e tyre në mënyrë objektive, të pavarur, të paanshme dhe duhet t'u përmbahen parimeve të fshehtësisë profesionale lidhur me informatat e mbledhura, analizat dhe të gjeturat tjera për të cilat mësojnë gjatë kryerjes së detyrës së tyre zyrtare dhe duhet t'u përmbahen praktikave jo diskriminuese, në pajtim me ligjin.

KREU II

KRYERJA E EKZAMINIMEVE MJEKOLIGJORE

Neni 2

Ekspertët që kryejnë ekzaminimet mjekoligjore

1. Të gjitha ekzaminimet mjeko-ligjore kryhen nga specialisti (ekspert) i certifikuar mjekoligjor.
2. Ekzaminimet mjeko ligjore mund kryhen edhe nga specializanti i mjekësisë ligjore nën mbikëqyrjen e specialistit mjekoligjor.

Neni 3

Vendi i kryerjes së ekzaminimeve mjekoligjore

1. Të gjitha ekzaminimet mjekoligjore kryhen në lokalet e Departamentit të Mjekësisë Ligjore.
2. Në raste të jashtë zakonshme gjykata mund të urdhëroj kryerjen e ekzaminimeve mjekoligjore jashtë lokaleve të Departamentit të Mjekësisë Ligjore, pasi që të sigurohen kushte të përshatshme për një gjë të tillë .

Neni 4

1. Autopsia mjekoligjore kryhet vetëm në bazë të urdhrit të lëshuar nga gjykata kompetente.
2. Autopsia mjekoligjore kryhet por nuk kufizohet vetëm në këto raste:
 - 2.1. vrasje apo vrasje të dyshuar;
 - 2.2. vdekje e papritur e befasishme;
 - 2.3. dyshimi për torturë apo çfarëdo forme tjetër të keqtrajtimit ;
 - 2.4. vetëvrasje apo vetëvrasje e dyshuar;
 - 2.5. dyshimet gjatë mjekimit;
 - 2.6. aksidentet transportuese, profesionale apo shtëpiake;
 - 2.7. sëmundjet nga profesioni dhe rreziqet;
 - 2.8. fatkeqësitë teknologjike apo mjedisore;
 - 2.9. vdekja gjatë kohës së arrestimit, ndalimit, paraburgimit dhe burgimit;

- 2.10. vdekja lidhur me veprimtarinë policore, apo ushtarake;
 - 2.11. trupat e paidentifikuara apo të skeletizuara;
 - 2.12. vdekjen gjatë operacionit, apo njëzetekatër (24) orë pas operacionit, anestezionit, apo ndonjë ndërhyrje tjetër mjekësore;
3. Procesverbali i autopsisë mjekoligjore duhet të jetë pjesë integrale e procedurave të autopsisë mjekoligjore.
 4. Procesverbali i autopsisë mjekoligjore nënshkruhet nga specialisti apo anëtarët e panelit të ekspertëve mjekoligjor të cilët e kanë kryer autopsinë.

Neni 5

Afati për kryerjen ekzaminimeve mjekoligjore dhe autopsisë

1. Të gjitha ekzaminimet mjekoligjore duhet të kryhen pa vonesë.
2. Autopsia, mjekoligjore, nuk mund të kryhet më herët se gjashtë (6) orë nga momenti i konstatimit të vdekjes nga mjeku.
3. Të gjitha raportet e autopsisë mjekoligjore duhet të përfundohen dhe nënshkruhen dhjetë (10) ditë pas pranimit të rezultateve laboratorike. Kurse raporti përfundimtar i ekspertëve të mjekësisë ligjore duhet të përpilohet brenda tri (3) ditëve të punës pas ekzaminimit klinik mjekoligjor.
4. Në raste të veçanta kufizimi i afateve i përcaktuar në paragrafin 3 të këtij neni mund të zgjatet me miratimin me shkrim të drejtorit të Departamentit të Mjekësisë Ligjore. Miratimi me shkrim duhet të paraqet çartë arsyet e zgjatjes së afatit kohorë.
5. Të gjitha ekzaminimet mjekoligjore konsiderohen të përfunduara kur specialisti mjekoligjor përgatit dhe nënshkruan raportin përfundimtar.

Neni 6

Shpenzimet e Autopsisë

Shpenzimet e autopsisë bien në barrë të organit apo subjektit me urdhrin apo kërkesën e të cilit është kryer autopsia.

KREU III

OBJEKTIVITETI, FSHEHTË SIA PROFESIONALE DHE BENEFICIONET

Neni 7

Fshehtësia e informatave

1. Informatat e mësuar gjatë kryerjes së ekzaminimeve mjekoligjore janë të fshehta për opinionin.
2. Zbulimi i informatave të parapara me paragrafin 1. të këtij neni mund të bëhet pas urdhrorit të lëshuar nga gjykata kompetente.
3. Të gjitha të dhënat e mbledhura nga Departamenti i Mjekësisë Ligjore duhet të mbështetën në ligjin për mbrojtjen e të dhënave.

Neni 8

Obligimet e organeve hetimore dhe gjyqësore për autopsinë mjekoligjore

1. Organet hetimore dhe gjyqësore duhet menjëherë ta informojnë Departamentin e Mjekësisë Ligjore për rastet për të cilat kërkohet të bëhet ekzaminimi mjekoligjor
2. Autoritetet hetuese duhet t'i ofrojnë Departamentit të Mjekësisë Ligjore çfarëdo fakti, mostre biologjike, dokument origjinal apo çfarëdo material tjetër e cila mund ti ndihmoj ekspertizës mjekoligjore.
3. Departamenti i Mjekësisë Ligjore duhet të merr në ruajtje trupin e vdekur, rrobat, mostrat biologjike dhe çfarëdo material tjetër lidhur me vendin e vdekjes, që mund të ndihmoj ekspertizën mjekoligjore.

Neni 9

Zhvarrosja

Zhvarrosja e trupit apo e pjesëve trupore duhet të bëhet nga Departamenti i Mjekësisë Ligjore vetëm me urdhër të gjykatës.

Neni 10

Varrimi dhe lirimi i trupit dhe gjësendeve personale

1. Pasi që autopsia të kryhet, trupi i vdekur i identifikuar, pjesët e trupit dhe mbetjet mortore u kthehen anëtarëve të familjes në rast se nuk ekziston nevoja për ekzaminime të mëtejshme mjeko ligjore.

2. Departamenti i Mjekësisë Ligjore duhet të kërkoj urdhër nga gjykata me kërkesën e të cilëve është bërë autopsia, për ta bërë varrimin në rastet në vijim:

2.1. nëse trupi i vdekur apo pjesët e trupit të vdekur nuk janë identifikuar edhe pas shterjes së të gjitha mundësive brenda gjashtë (6) muajve;

2.2. nëse nuk ka anëtar të identifikuar të familjes që ta pranojnë trupin apo pjesët e trupit;

2.3. anëtarët e identifikuar refuzojnë ta marrin trupin e vdekur të identifikuar apo pjesët e trupit;

2.4. nëse për çfarëdo arsye nuk është e mundur ti kthehet anëtarëve të familjes trupi apo pjesët e trupit për varrim.

3. Departamenti i Mjekësisë Ligjore do të dorëzoj Policisë çfarëdo gjësendi që xhindet në trupin e kufomës duke përfshirë rrobat dhe gjësendet personale, të cilat nuk janë mbledhur me parë nga policia në vendin e ngjarjes.

Neni 11 **Ekzaminimi klinik mjekoligjor**

1. Departamenti kryen të gjitha ekzaminimet klinike mjekoligjore të cilat përfshijnë por nuk kufizohen në:

1.1. përcaktimin e mjetit dhe shkallën e dëmtimeve trupore;

1.2. përcaktimin e shkallës së aftësisë për punë, gjendjen shëndetësore, moshën dhe identitetin;

1.3. përcaktimin e gjendjes seksuale dhe ekzaminimet mjekoligjore të personit që është viktimë e veprës penale kundër integritetit seksual;

1.4. përcaktimin e atësisë dhe amësisë;

1.5. dyshimet për abuzim të fëmijës;

1.6. lëndimet trupore;

1.7. traumat si pasojë e përdorimit të alkoolit dhe substancave narkotike psikotrope;

1.8. abortimet jo ligjor dhe të dyshimta;

1.9. lëndimet e dyshimta jo aksidentale;

1.10. transplantimet e dyshimta jo ligjore të organeve, indeve dhe qelizave.

2. Ekzaminimet mjekoligjore klinike duhet të kryhen në viktimën dhe kryesin e dyshuar.
3. Ekzaminimi klinik mjekoligjor duhet të kruhet vetëm pasi të informohet pacienti për natyrën e ekzaminimit që duhet të kryhet dhe pas marrjes së pëlqimit me shkrim nga pacienti. Në rast të refuzimit pa arsye vlejné dispozitat e kodit të procedurës penale.
4. Kur pacienti është nën moshën tetëmbëdhjetë (18) vjeçare apo nuk është në pozitë të jap pëlqimin, pëlqimi i paraparë në paragrafin 3. të këtij neni duhet të merret nga prindi apo përfaqësuesi ligjor i pacientit.
5. Ekzaminimet mjekoligjore klinike të parapara në paragrafin 3 dhe 4 të këtij neni kryhen pas kërkesës me shkrim nga organet e hetuesisë apo gjyqësisë.

Neni 12 Ndhma

1. Nëse gjatë ekzaminimit *post mortum* mjeko ligjor nevojitet ndihma e specialistëve të fushave të tjera mjekësore, Departamenti i Mjekësisë Ligjore formon komisionin përkatës.
2. Përbërja e komisionit dhe rregullat e punës përcaktohen me rregullat e brendshme të Departamentit të Mjekësisë Ligjore.

Neni 13 Procedurat operative mjeko ligjore

1. Të gjitha ekzaminimet mjekoligjore kryhen në pajtim me ligjin dhe rregullat e brendshme të nxjerra nga Departamenti i Mjekësisë ligjore.
2. Të gjitha aktivitetet ndërlidhur me mjekësin ligjore përfshirë toksikologjinë mjekoligjore, histopatologjinë, antropatologjinë, psikiatrinë, biologjinë dhe të gjitha fushat tjera rregullohen me rregullat e brendshme të Departamentit të Mjekësisë Ligjore.
3. Procedurat e ekzaminimeve mjekoligjore të përcaktuara në rregullat e brendshme të Departamentit të Mjekësisë Ligjore përfshijnë por nuk kufizohen në:
 - 3.1. praninë e ekspertit mjekoligjor në vendin e vdekjes apo të gjetjes së kufomës;
 - 3.2. mënyrën e ruajtjes së mbetjeve mortore dhe dëshmive të mbledhura në vendin e ngjarjes ku ka ndodhur vdekja;
 - 3.3. trajtimin apo riatdhesimin e mbetjeve mortore;
 - 3.4. autopsitë mjekoligjore;

- 3.5. vlerësimin e vendndodhjeve, gjurmimit dhe zhvarrosjen;
- 3.6. mbledhjen, ruajtjen, analizimin dhe dhënien e indeve njerëzore për qëllime histopatologjike;
- 3.7. analiza toksikologjike mjekoligjore;
- 3.8. dokumentimin dhe certifikimin e ekzaminimeve;
- 3.9. raportimet mjekoligjore;
- 3.10. ruajtjen dhe analizimin e mbetjeve skeletore njerëzore;
- 3.11. përbërjen e panelit të ekspertëve të mjekësisë ligjore;
- 3.12. ekzaminimet klinike mjekoligjore të cilat kërkojnë shërbimet e infermiereve mjekoligjore;
- 3.13. mbledhjen e lëngjeve trupore të pacientëve të gjallë;
- 3.14. identifikimin;
- 3.15. riatdhesimin, ruajtjen dhe analizimin e indeve njerëzore dhe mostrave në gjendje të lëngët;
- 3.16. ekzaminimet dentale;
- 3.17. procedimin, regjistrimin dhe ruajtjen e rezultateve personale;
- 3.18. dërgimin e mostrave në laboratorët e forenzikës;
- 3.19. identifikimin, procedimin dhe trajtimin e ngjarjeve fatale;
- 3.20. menaxhimin e fatkeqësive (katastrofave) madhore dhe ndihmën ndaj shoqërisë civile;
- 3.21. hulumtimet shkencore, arsimimin dhe trajnimin mjekoligjor;
- 3.22. arsimimin dhe trajnimin në fushën e arkeologjisë dhe antropologjisë ligjore.

Neni 14

Orari i punës

1. Për shkak të kushteve specifike dhe rrezikshmërisë së lartë për shëndetin, personeli i Departamentit të Mjekësisë Ligjore nuk mund të kalojë më shumë se gjashtë (6) orë në procesin e autopsisë ose ekzaminimet e tjera.
2. Çështja e pagesës për personelin në gatishmëri e paraparë në paragrafin 1. të këtij neni rregullohet me akt të veçantë nënligjor, të cilin e nxjerr Qeveria.
3. Personelit të Departamentit të Mjekësisë Ligjore nga paragrafi 1. i këtij neni i paguhet një shtesë e të ardhurave personale.
4. Kategorizimi i nivelit të të ardhurave shtesë të parapara në paragrafin 2. të këtij neni rregullohet me akt të veçantë nënligjor të cilin e nxjerr Qeveria.

Neni 15

Puna jashtë orarit dhe pjesëmarrja në seanca gjyqësore

1. Puna e ekspertëve të mjekësisë ligjore jashtë orarit të tyre të punës kompensohet për secilin rast veç e veç, nga gjykata e cila ka kërkuar ekspertimin mjeko-ligjor, në pajtim me aktin e veçantë nënligjor të cilin e nxjerr Qeveria.
2. Për secilin rast të pjesëmarrjes në seancë gjyqësore, eksperti i mjekësisë ligjore do të kompensohet, në pajtim me aktin nënligjor të nxjerrë nga Qeveria.

Neni 16

Përgjegjësitë

Për shkeljen e këtij ligji ekspertët e mjekësisë ligjore i nënshtrohen masave disiplinore dhe sanksioneve penale sipas legjislacionit në fuqi.

KREU IV

DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 17

Nxjerrja e akteve nënligjore

Aktet nënligjore për zbatim të këtij ligji do të nxirren brenda gjashtë (6) muajve prej ditës hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 18
Shfuqizimi

Pas hyrjes në fuqi të këtij ligji shfuqizohen të gjitha dispozitat juridike me të cilat është rregulluar çështja e mjekësisë ligjore.

Neni 19
Hyrja në Fuqi

Ky ligji hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Ligji Nr. 03/L-187
25 shkurt 2010

Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Jakup KRASNIQI